

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në lëndën penale ndaj të akuzuarit E.Th. me vendbanim në ..., Lagja ..., për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.2331/2013, e datës 18.11.2013, të cilën e përfaqësonte prokurorja Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe publik, më datën 26.09.2018, mori dhe shpalli këtë :

### A K T G J Y K I M

I pandehuri E.Th. nga babai, N., i lindur ... në fshatin ... K. ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i 3 femijeve, me vendbanim në Gjilan Lagja ..., i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. të telefonit ..., i gjykuar, nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale, konform nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP,

### LIROHET NGA AKUZA

Sepse më datë 14.09.2013, rreth orës 15,05 minuta, në shtëpinë e tij në Gjilan, i akuzuari E.Th. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka keqpërdorur besimin e dhëndrit të vet V.B., në atë mënyrë që për derisa i dëmtuari V. kishte shkuar mysafir në shtëpinë e vjehrrit E.Th. dhe derisa i dëmtuari ishte duke qëndruar në terasë të shtëpisë, i akuzuari hynë në dhomën ku ka qëndruar V. dhe nga portofoli i tij merr 2 (dy) euro dhe dokumentin amerikan të udhëtimit (travel dokument) dhe pa u hetuar del nga dhoma, në këtë mënyrë i akuzuari ka keqpërdorur besimin dhe me këtë rast të njëjtit i shkakton edhe dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

me çka kishte me kryer veprën penale Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KPRK. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### A r s y e t i m

Kundër të pandehurit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njejtë ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor.

Në shqyrtimin e fundit gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 26.09.2018, prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, në fjalën përfundimtare deklaroi, mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe propozimeve që e njejtë i përmban pasi që gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar me dëgjimin e dëshmitarëve dhe leximin e deklaratës së të dëmtuarit, kërkojmë nga gjykata që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta denoj sipas ligjit, gjatë shqyrtimit të denimit ti ketë parasyshtë rethanat lehtsuese dhe rënduese.

I akuzuari E.Th., në fjalën përfundimtare deklaroi: nuk e ndiej veten fajtor pasi që këtë vepër nuk e kam kryer për çka ju betohem në fëmijët e mi dhe nga gjykata kërkoj që të më liroj nga përgjegjësia penale.

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se në këtë çështje penale nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, sipas aktakuzës së lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm.

Këtë gjendje faktike, gjyqtari i vetëm gjykues e konstatoi duke u bazuar në këto prova: Dëshmia e dëshmitarve A.Th. dhe B.F. si dhe deklaratat e të dëmtuarit V.B. të dhënë në Stacionin Policor në Gjilan, Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit ... të datës 04.11.2013, dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

**Dëshmitarja A.Th.**, deklaroi: unë jam e martuar në Shkup, me V. më herët kam qenë e fejuar dhe kam bashkëjetuar një vit të plotë, pasi që kemi qenë edhe fqinjë, unë tre muajtë e parë kam banuar në shtëpinë e V. por gjatë asaj kohe V. ka nejtë më tepër në shtëpinë time pasi që ka qenë moshatarë me vëllezërit e mijë dhe kjo ka qenë në vitin 2013. V. në atë kohë në shtëpinë e tij ka jetuar me prindërit dhe vëllezërit e tij, në atë kohë V. me familjen e tij kanë ardhur nga Amerika për të jetuar në Gjilan, babai im E. gjatë kohës sa kam jetuar unë në shtëpinë e V. ka ardhur disa herë që është gjë normale. Në dhomën e gjumit ku kemi qenë unë dhe V. kemi pasur qasje vetëm ne e rrallë ndonjëherë mami i V., ndërsa E. në atë dhomë nuk ka pasur qasje asnjëherë, V. ka ardhur në Kosovë me Grin kartë amerikane. Unë lidhur me këtë rast e kam dhënë një deklaratë në polici dhe nuk më kujtohet në tërësi se çka kam thënë. për herën e fundit kur kam parë pasapartën amerikane ka qenë në shtëpinë time më 08.09.2013, ku në dhomën time ka pasur qasje babai im E. dhe të tjerët të familjas në të cilët anëtar nuk dyshojë. Personat të cilët nuk dyshoj janë vëllezërit dhe nënës ndërsa dyshoj në babain tim E.. Unë këtë deklaratë e kam dhënë se dyshoj se dokumentin Amerikan e ka marrë babai im sepse e ka parë burri im V. duke hyrë në dhomë, e unë kam qenë duke fjetur, babai im E. nuk e ka marrë dokumentin e udhëtimit dhe 2 € nga portofoli i V., por ai ka dyshuar vetëm pse e ka parë babain tim duke hyrë në dhomën tonë e edhe unë këtë deklaratë e kam dhënë se kam dyshuar në babain tim pasi që V. e ka parë babain tim duke hyrë në dhomën tonë.

Kjo deklaratë është në përputhje me deklaratën e dëshitarit B.F. i cili në séance ka deklaruar se e ka intervistuar V. dhe se i njejtë gjatë intervistimit ka deklaruar se dyshon se dokumenti i udhëtimit i ka humbur në shtëpinë e E.Th. por i njejtë ka deklaruar se nuk dyshon në asken e as ta ketë parë E. duke ia marrë pasaportën si dhe deklaratën e të dëmtuarit V.B. të dhënë në Stacionin Policor në Gjilan ku ndër të tjera ka deklaruar se kur është pregaditur për të shkuar për Amerikë e ka vërejtur se i mungon pasaporta Amerikane dhe se para një muaji e kam lënë te e fejuara ime A.Th. me të cilën jam fejuar para 1 muaji dhe **se dyshoj te prindi i saj pasi që duke e parë gjendjen financiare të tij mos ma ka marrë dhe mos po don me ma shitë...**

**I akuzuari E.Th.**, në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor e ka kontestuar në tërësi veprën penale, dhe ka shtuar, gjatë vitit 2013 V. ka qëndruar rreth një muaj në shtëpinë time pasi që ka qenë i fejuar me vajzën time A. dhe i njëjti deri sa ka qëndruar në shtëpinë time asnjëherë nuk është ankuar se i ka humbur pasaporta dhe unë për këtë kam marr vesh pasi që jam ftuar në Polici për intervistim të cilët më kanë pyetur se mos ia kam marr unë pasaportën V., dhe unë ju kam thënë se nuk ia kam marr dhe se V. nuk ka pasur pasaportë por siq na ka treguar ai e ka pasur dokunmentin e udhëtimit –grin kartën, për këtë arsye ai me vajzën time dhe babain e tij kanë shkuar në Serbi dhe e kanë marrë një pasaportë serbe për tu kthyer në Amerikë. Arsyeja pse V. ka deklaruar se dyshon në mua mendoj se këtë e ka bërë babai i tij që ai të shkoj në shtëpinë e vet dhe mos të qëndroj tek unë dhe për të mundur me nxjerr ma lehtë pasaportën serbe.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e vlerësoi me shumë kujdes mbrojtjen e të akuzuarit i cili nuk e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe të njëjtës ia fali besimin, ngase një mbrojtje e tillë është në harmoni me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në veçanti, me Dëshmia e dëshmitarve A.Th. dhe B.F. si dhe deklaratat e të dëmtuarit V.B. të dhënë në Stacionin Policor në Gjilan dhe Raportin fillestar i incidentit me nr. të rastit 2013-CA-1745 të datës 04.11.2013. Nga këto prova është vërtetuar pa asnjë mëdyshje se i akuzuari E.Th. nuk ka kryer veprën penale

Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KPRK -s, pasi që në këtë dispozitë është parashikuar se këtë vepër penale e kryen “ Kushdo që gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t’i shkaktojë dëm personit interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij,”

Gjyqtari i vetëm gjykues i vlerësoi këto prova dhe në bazë të tyre gjykata e ka pranuar në tërësi mbrojtjen e të akuzuarit E.Th. ngase është e logjikshme dhe në masë të madhe e arsyeshme dhe në harmoni me provat tjera.

Nga këto prova është vërtetuar pa asnjë mëdyshje se i akuzuari E.Th., nuk ka kryer veprën penale, pasi nga dëshmia e dëshmitarve A.Th. dhe B.F. si dhe deklarata e të dëmtuarit V.B. nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka marrë dokumentin e udhëtimit të dëmtuarit V. pasi që as dëshmitarët e as i dëmtuari nuk ka në dekluarar se e kanë parë të pandehurin duke ja marrë dokumentin e udhëtimit, **por i dëmtuari ka deklaruar se dyshoj se duke e parë gjendjen ekonomike mos ma ka marr dokumentin E.Th. dhe po dyshoj se mos po donë me ma shitë pasaportën, ose që mos ta lë vajzën e tij.....**gjë të cilën e ka vërtetuar edhe dëshmitarja A. e cila në seancë ka deklaruar se unë kam dyshuar në prindin E. pasi që më ka thënë i fejuari im V. se e ka parë duke hyrë në dhomë ku i ka pasur sendet, prandaj gjykata vetëm në bazë të dyshimit të dëmtuarit V.nuk ka mundur ta shpallë fajtor dhe ta dënoj të pandehurin.

Andaj, me që nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke u bazuar në nenin 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP, të akuzuarin e liroi nga akuza. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 454 paragr

afi 1 të KPP, ndërsa vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 3 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjyqtari vetëm gjykues ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i përgjithshëm**

**P.nr. 412/2018, Më 26.09.2018**

**Sekretarja juridike,**  
Fatmire Sermaxhaj d.v

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.